



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:189991
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05412347

C.nr.543/2014

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditësit Pro Credit Bank, rr."Mbretëresha Teutë" p.nr, Mitrovicë të cilin sipas autorizimit e pëfaqëson Florian Ujkani, kundër të paditurve 1.S.B dhe 2. A.M nga Mitrovica rr."Fadil Franca" Mitrovicë, me objekt të kontestit pagimin e borxhit për kredinë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit Pro Credit Bank në tërësi si e bazuar.
- II. **OBLIGOHEN** të paditurit 1.S.B dhe 2. A.M nga Mitrovicë që paditësit t'ia paguajnë borxhin në lartësi prej 8,126.17€, në emër të kredisë, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- III. **OBLIGOHEN** të paditurit 1.S.B dhe 2. A.M që t'ia kompensojnë të paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 50.00€, në afat prej 15 ditësht nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Arsyetim

1. Pretendimet e palëve

Paditësi Pro Credit Bank, me datën 29.09.2014, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurve 1.S.B dhe 2 A.M nga Mitrovica, me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit që të paguajnë borxhin ndaj paditësit në shumë prej 7,634.26€, me kamatë ligjore që nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagimin përfundimtar të borxhit, e që rrjedh nga amandamenti i kontratës për kredi biznesi me numër 60057930 e datës 14.12.2012 dhe planit të pagesave.

Në seancën kryesore të datës 01.03.2024, i autorizuari i paditësit deklaroi se qëndojmë pranë padisë dhe kërkesëpadiisë dhe e precizojmë padinë dhe kërkesëpadiinë ashtu që lartësia e kërkesëpadiisë është 8,126.17€ dhe ky do të jetë borxhi tash e tutje pasi që nuk i rrjedhë kamatëvonesa dhe interesi për shkak të kategorisë write off.

I padituri S.B në seancën kryesore deklaroj se nuk e kontestojë padinë dhe kërkesëpadinë sepse kredinë e kam marrë, mirëpo për shkak të problemeve shëndetësore nuk kam mund ta paguaj dhe nuk kam mundësi ende ta paguaj, unë jam i vetëdijshëm se kam borxh por kam pasur probleme të rënda shëndetësore. Pasi kam marrë kredinë unë kam pasu një aksident si pasojë e të cilit i kam pasur këto probleme dhe e kam humbur edhe vendin e punës ku kam qenë duke punuar në Bashkësinë Islame. Unë prap duhet të bëj një operim dhe as këtë vit nuk kam mundës të filloj me pagesat e kreditit.

E paditura A.M në seancën kryesore deklaroj se borxhit nuk i ikum dhe ky borxh duhet të paguhet por unë në vitin 2022 me ndihmën e parave të popullit jam shëruar nga sëmundja e leukemisë në shtetin e Turqisë, ndërsa një vit pas meje burri im Samia e ka pasur aksidentin dhe është i operuar dhe nuk mund të punojë punë të rënda dhe duhet t'i nënshtrohet operimit. Ne nuk kemi kushte dhe unë jam me terapi mjekësore për 6 vite dhe ne nuk kemi mundësi ta bëjmë pagesën e këtij borxhi për momentin dhe jo pse ne nuk dojmë.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: amandamenti për kontratën e kredisë për biznes e datës 14.12.2012 dhe plani i pagesave për kthimin e kredisë për S.B.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

3. Faktet

Me leximin e amandamentit për kontratën e kredisë për biznes e datës 14.12.2012 dhe planit të pagesave për kthimin e kredisë, gjykata vërtetoi faktin se të paditurit S.B dhe A.M me datën 14.12.2012, kanë marrë kredi në shumën prej 7,100.71€ dhe sipas planit të kredisë të njëjtin borxh është dashur ta kthejnë deri me datën 14.12.2016.

4. Ligji i aplikueshëm

Në bazë të nenit 130 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet që “*Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese.*”

Në bazë të nenit 245 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet që “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*”

5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, e njëjta duhet të aprovohet.

Gjykata në bazë të provave të administruara, përkatësisht amandamentit për kontratën e kredisë për biznes e datës 14.12.2012, vërtetojë faktin se të paditurit kanë marrë kredi nga paditësi në shumën prej 7,100.71€ dhe sipas planit të kredisë të njëjtin borxh është dashur ta kthejnë deri me datën 14.12.2016. Faktin se këtë kredi të njëjtit nuk e kanë paguar, të paditurit nuk e kundërshtojnë, madje të njëjtit këtë fakt e pohojnë mirëpo deklarojnë se për shkak të problemeve shëndetësore që kanë pasur nuk kanë arritur ta paguajnë këtë obligim.

Gjykata, vlerëson se në bazë të dispozitës së nenit 130 paragrafi 1 dhe 245 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duhet të përmbushin obligimin ndaj paditësit dhe nuk kanë ndonjë bazë për lirim nga pagimi i këtij obligimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi komfor nenit 452 të LPK-së, duke marrë parasysh se të paditurit e kanë humbur kontestin dhe paditësi ka kërkuar kompenzimin për pagesën e taksës gjyqësore në lartësi prej 50€.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.543/2014, datë 05.03.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjës së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.